

ata shkuan dhe u vendosen te disa miq në Isniq/Istinić. Atje më herët i kishin shkuar bashkëshortja, nëna, vajzat dhe nipërit. Të nesërmen, më **1.06.1998**, Ramadani u kthye në shtëpi për ta lëshuar bagëtinë në kullotë. Nga ajo ditë zhduket çdo gjurmë për të. Bashkëshortja dhe vajzat janë kthyer në fshat më 27.02.1999. E gjetën shtëpinë e tyre të djegur. Në afërsi të shtëpisë, në një kanal me ujë, e kanë zbuluar edhe trupin e Ramadanit. E kanë varrosur në varrezat lokale.

Burimi: deklarata S.D, FDH-17908.

Avdyli (Jahë) Dobraj

(15.04.1928, shqiptar nga Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, pesë fëmijë)

Avdyli dhe i biri me familje e kishin braktisur Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg më 29.05.1998, kur forcat serbe e sulmuan fshatin me bombardime. U strehuan në fshatin Kodrali/Kodralija. Në datën **1.06.1998**, Avdyli e kishte marr rrugën për në fshatin e tij dhe nga ajo ditë familja nuk dinte asgjë për të. Djali i Avdyilit u kthye në fshat në fund të muajit gusht të vitit 1998. Atëherë ka mësuar se policët [apo ushtarët] serbë ia kishin vrarë të atin, po atë ditë kur Avdyli u kthye në fshat. Trupin e tij e kanë çuar në fushën e komshiut Qaush Loshajt dhe e kanë hedhur dheun mbi të. Qaushi shumë shpejt e ka zbuluar kufomën e Avdyilit dhe për këtë e ka njoftuar familjen Dobraj. Në datën 30.08.1999, familjarët i kanë varrosur mбетjet mortore të Avdyilit në varrezat lokale.

Burimet: deklarata M.D, FDH-17904; deklarata NN, FDH-12201.

Blerim (Ahmet) Dërvishaj

(13.03.1974, shqiptar nga Irzniqi/Rznić, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së

Lavdim (Rexhep) Likaj

(11.03.1978, shqiptar nga Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Blerimi u bë pjesëtar i UÇK-së më 20.04.1998, ndërkaq Lavdimi u radhit në mesin e pjesëtarëve të saj në fillim të luftës.

Që të dy kanë marrë pjesë në transportin e armatimeve nga Shqipëria për në Kosovë.

Në datën **1.06.1998**, gjatë përlëshjeve me forcat serbe në Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg, Blerimi dhe Lavdimi gjendeshin pranë shkollës *Lidhja e Prizrenit/Prizrenska liga*. Një predhë ka rënë afër tyre duke i vrarë që të dy në vend. Trupat e tyre nuk janë gjetur as sot e kësaj dite. Janë të evidentuar si të zhdukur në listën e KNKK-së. Lënda e Blerimit e mban numrin rendor BLG-803255-01, ndërkaq ajo e Lavdimit BLG-801784-01.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; deklarata S.D, FDH-12203; deklarata NN, FDH-12090; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Željko (Ilija) Šijan

(12.02.1960, serb nga Beogradi, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Željko ka qenë me origjinë nga rrethina e Graçacit [Kroaci]. E ka mbaruar shkollën e mesme hekurudhore. Pastaj e ka kryer edhe trajnimin për oficer policie. Ka filluar nga puna në MPB-në e Serbisë më 1.03.1997. Ishte pjesëtar i Njësitit për Operacione Speciale [NJOS] në kuadër të Shërbimit të Sigurimit Shtetëror. E kanë vrarë më **1.06.1998**, gjatë një sulmi të UÇK-së në rrugën Deçan/Deçane – Gjakovë/Đakovica, në fshatin Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg.

Burimet: KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SV SRJ, *Junaci otadžbine, 75; Pjesëtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme – viktimat e terrorizmit shqiptar në vitin 1998*, <http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html>, FDH-31078; *Ovo se neće ovako završiti, ili ćemo svi izginiti, a to će malo teže ići, ili će oni dati ostavke*, FHP31177.

Hazir (Selim) Hulaj

(13.03.1929, shqiptar nga fshati Hulaj/Huljaj, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, gjashtë fëmijë)

Forcat serbe e kanë sulmuar fshatin Hulaj/Huljaj herët në mëngjes, më **1.06.1998**. E reja e Hazirit ka ikur me fëmijët nga fshati, ndërkaq bashkëshorti i saj, djali i Hazirit,